



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje me nenin 47, paragrafi (1), pika 6), dhe në pajtim me nenin 19, paragrafi (2) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

V E N D I M

për përcaktimin e instrumenteve të garancisë gjatë zbatimit të operacioneve monetare

1. Me këtë vendim në kuadër të kushteve dhe rregullave të përgjithshme për zbatimin e operacioneve monetare, përcaktohen instrumentet e garancisë, të cilat i përdor Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore) gjatë zbatimit të operacioneve monetare. Operacionet monetare me të cilat realizohet lëshimi ose tërheqja e likuiditetit në baza të përkohshme dhe/ose përfundimtare, zbatohen me bankat, filialet e bankave të huaja dhe kursimoret (në tekstin e mëposhtëm: pjesëmarrësit), të cilat i plotësojnë kriteret e qasjes të përcaktuara me aktet nënligjore të Bankës Popullore.

Instrumentet nga paragrafi (1) i kësaj pike shërbejnë për mbrojtjen e Bankës Popullore nga rreziqet kreditore, të tregut dhe të likuiditetit.

2. Instrumentet e garancisë gjatë zbatimit të operacioneve monetare janë letrat me vlerë të borxhit.

Banka Popullore përdor letrat me vlerë të borxhit, afati i mbetur i të cilave është më i gjatë se maturimi i operacioneve monetare.

Banka Popullore mund të vendosë të mos pranojë letra me vlerë borxhi që kanë pagesë të kuponit të interesit për kohëzgjatjen e operacioneve monetare.

3. Gjatë zbatimit të operacionit monetar dhe gjatë kohëzgjatjes së tij, Banka Popullore vlerëson instrumentet e garancisë në baza ditore sipas çmimeve të tregut.

Çmimet e tregut janë çmimet e realizuara në tregun sekondar vendas, respektivisht çmimet e publikuara në sistemet elektronike të informacionit për tregjet financiare ndërkombëtare.

Me përjashtim nga paragrafi (1) i kësaj pike, nëse me instrumentet e garancisë nuk tregtohet në tregun sekondar ose çmimet e fundit të realizuara devijojnë ndjeshëm nga lëvizjet aktuale të tregut, Banka Popullore ka të drejtë të përcaktojë çmim teorik për vlerësimin e instrumenteve duke zbatuar metodologjinë e duhur të vlerësimit.

4. Banka Popullore përcakton koeficientin e mbulimit, si raport ndërmjet vlerës së instrumenteve të garancisë dhe mjeteve monetare.

Në operacionet monetare për lëshim të likuiditet në denarë në baza të përkohshme, vlera e instrumenteve të sigurisë është më e lartë se mjetet e miratuara.

Në operacionet monetare për tërheqje të likuiditetit në denarë në baza të përkohshme, vlera e instrumenteve të sigurisë është në shumën e mjeteve të tërhequra.

5. Gjatë kohëzgjatjes së operacioneve monetare, Banka Popullore e mbikëqyr vlerën e instrumenteve të garancisë në baza ditore.

Nëse raporti ndërmjet vlerës së instrumenteve të garancisë dhe mjeteve monetare zvogëlohet nën koeficientet e përcaktuara të mbulimit, Banka Popullore ka të drejtë të kërkojë mbulim në mjete monetare ose me instrumente përkatëse të garancisë. Përndryshe, nëse raporti ndërmjet vlerës së instrumenteve të garancisë dhe mjeteve monetare rritet mbi koeficientet e përcaktuara të mbulimit, Banka Popullore e kthen tepricën e garancisë me kërkesë të bankës.

6. Llojet e letrave me vlerë të përdorura nga Banka Popullore si instrumente të garancisë gjatë zbatimit të operacioneve monetare, si dhe koeficientet e mbulimit përcaktohen në Listën e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare, që e miraton Këshilli Ekzekutiv i Bankës Popullore.

Lista e letrave me vlerë për zbatimin e operacioneve monetare publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

7. Banka Popullore, u vë në dispozicion pjesëmarrësve në operacionet monetare listë të detajuar të instrumenteve të garancisë që i pranon gjatë zbatimit të operacioneve monetare, në baza ditore, nëpërmjet sistemit elektronik.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon së vlefshmi Vendimi për përcaktimin e instrumenteve të garancionit gjatë zbatimit të operacioneve monetare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 126/11).

9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02 – 43728/9
26 dhjetor 2024
Shkup

Guvernatorja dhe
kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut
д-р Анита Ангеловска-Бежоска